



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:132597

Datë: 12.12.2024

Numri i dokumentit: 06588599

C.nr. 402/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoreshen profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses B.K nga fshati Optrushë, Komuna e Rahovecit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokate I.Xh-K nga Suhareka, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me bazë juridike për kompensim i inflacionit, vlera e objektit të kontestit 636.65 euro, jashtë seancës, më datën 12.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses B.K.
- II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses B.K, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Maj - Dhjetor 2021 në shumën prej 106.89 euro, si dhe për periudhën kohore Janar - Nëntor 2022 në shumën prej 501.46 euro, në shumën e përgjithshme prej 608.35 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 07.05.2024, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit.
- III. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditëses B.K, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë përtej shumës prej 608.35 euro e deri në shumën 636.65 euro, dhe atë në shumën prej 28.3 euro.
- IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës paditëses, B.K, t’i paguajë shumën prej 124,00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja B.K përmes përfaqësueses të saj të autorizuar, më datën 07.05.2024, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, ka parashtruar padinë për kompensimin e diferencës në emër të shkallës së inflacionit, vlera e përgjithshme e kontestit prej 636.65 euro.

E njëjta sipas padisë ka theksuar se paditësja B.K ka punuar dhe vazhdon të punojë në SH.U.M “Lidhja e Prizrenit” në fshatin Opterushë, Komuna e Rahovecit, e që për periudhën e kërkuar paditëses i ka takuar e drejta e kompensimi në emër të inflacionit sipas Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës neni 35 paragrafi 10, por që deri më tani nuk është kompensuar. Periudha e kërkuar sipas padisë është nga data 09.05.2021 e deri më 21.11.2022. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen e saj në padi të datës 11.11.2024, ka theksuar se e kontestojmë padinë në tërësi për shkak se i mungon legjitimiteti real pasiv në këtë çështje kontestimore, padia është e pa themeltë dhe e pa bazuar ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit - DKA. Ndërkaq kërkesat që dalin nga kontestet e marrëdhënies së punës fillimisht duhet të parashtrohen tek punëdhënësi. Gjykata mund të shqyrtoj një padi që ka elemente nga kontesti i marrëdhënies së punës vetëm nëse paditëses i kanë shterur të gjitha mjetet në procedurë të rregullt pranë të paditurës si organ administrativ. Në këtë rast paditësi nuk ka parashtruar kërkesë për kompensim pranë të paditurës. Me rastin e lidhjes së kontratave kolektive në nenin 2 të dy kontratave janë deleguar kompetenca dhe detyrime për të paditurën pa u shoqëruar edhe me buxhet shtesë, këto detyrime nuk janë zbatuar nga niveli qendror i pushtetit. Në bazë të nenit 87 të Ligjit të punës, të gjitha kërkesat në para parashkruhen brenda afatit prej (3) tre vitesh.

Ka shtuar se MASHT dhe SBASHK nuk kanë zbatuar asnjë nga dispozitat e nenit 46 për angazhimin e përbashkët të zbatimit të dispozitave që kanë implikime financiare. Baza ligjore për sigurimin e fondeve për realizimin e buxhetit të nevojshëm sipas nenit 35 paragrafët 5,7 dhe 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit, nga hyrja në fuqi e Kontratës Kolektive të Arsimit, Ministria e Arsimit dhe Ministria e Financave asnjëherë nuk kanë ndarë mjetet financiare për Komunar, respektivisht për këtu të paditurën Komuna e Rahovecit, me qëllim të ndarjes së buxhetit të nevojshëm të përcaktuar në nenin 35 paragrafët 5, 7 dhe 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës. Paditësja nuk i ka shtjerë të gjitha mundësitë ligjore në procedurën administrative, për këtë qëllim Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit e Komunës së Rahovecit ka themeluar një komision të punës për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit, me qëllim të verifikimit të gjendjes faktike për të gjithë punëtorët e arsimit të cilët kanë patur në Komunën e Rahovecit – DKA. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontratat e punës për paditësen të lëshuar nga Komuna e Rahovecit – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën “ Lidhja e Prizrenit”, në fshatin Opterushë, Komuna e Rahovecit. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është në shumën prej 393.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksën e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses B.K, i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë në pjesën tjetër në shumën prej 28.3 pasi që paditësja B.K përfiton ngritje në bazë të pagës bazë (393) euro dhe jo (411.33) euro siç ka kërkuar në padi.

Sa i përket çështjes së parashkrimit, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës për faktin se padia e paditëses është dorëzuar më datën 07.05.2024, e që është brenda afatit kohor 3 vjeçar. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Prandaj edhe kërkesa është brenda afatit 3 vjeçar.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk*

është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta refuzojë pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësve, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtutjeshëm LPK), ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”,* ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.*

Sa i përket legjitimitetit real pasiv të palës së paditur, gjykata vlerëson se pala e paditur ka legjitimitet që të jetë e paditur në këtë çështje kontestimore për faktin se sipas nenit 2 par.1 pika 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, dispozitat e kësaj kontrate kolektive të arsimit janë të obligueshme për të gjithë punëdhënësit e sektorit të arsimit në Kosovë, përfshirë edhe komunat dhe drejtoritë komunale të arsimit.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palës së paditur, por nuk ishin relevante në zgjidhjen e kësaj çështje kontestimore.

Vendimin lidhur me kamatën në lartësi prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës, nenit 2 par.1 pika 1.2 dhe neni 35 par.5 dhe par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, nenit 398 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyq fituese, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore”,* në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyq fituese, duke vendosur që paditësja t’ia kompensojë të paditurit shumën si në pikën VI të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 125,00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 104 euro si dhe për taksën gjyqësore 21.00 euro.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.402/2024, më datën 12.12.2024

B.Profesionale
Shpresa Haxhijaha Rahmani

Gjyqtari
Avni Berisha

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.